

VENDIM
Nr.855, datë 19.12.2003

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 588, DATË 22.12.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROCEDURËN ZYRTARE TË ÇAKTIMIT TË
DELEGACIONIT SHQIPTAR NË KONGRESIN EUROPIAN TË AUTORITETEVE
LOKALE DHE RAJONALE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.588, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Delegacioni shqiptar në Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Europës përbëhet nga katër anëtarë dhe katër zëvendësues, përkatësisht të ndarë në:

- dy anëtarë dhe dy zëvendësues (përfaqësues nga organet e zgjedhura vendore të bashkive dhe komunave), që marrin pjesë në Dhomën e Autoriteteve Vendore të Kongresit;

- dy anëtarë dhe dy zëvendësues (përfaqësues nga organet e zgjedhura të qarqeve), që marrin pjesë në Dhomën e Autoriteteve Rajonale të Kongresit.”.

2. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Përbërja e delegacionit shqiptar në Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Europës përcaktohet nga shoqatat vendore të të zgjedhurve, sipas një procedure të përcaktuar nga ata vetë, në raport me vendet e përfaqësimit në dy dhomat, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi. Anëtarët e delegacionit duhet të kenë mandatin e të zgjedhurit vendor në zgjedhjet e fundit, të zhvilluara në komunën, bashkinë apo qarkun përkatës.”.

3. Në pikën 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“ Procedurat dhe kriteret për përcaktimin e zëvendësuesve në delegacion janë të njëjta me ato të përcaktimit të anëtarëve.”.

4. Në pikat 4 e 5, emërtimet “Sekretariati i Kongresit European të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale” dhe “Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës” zëvendësohen me “Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës”.

5. Në të gjithë vendimin fjala “Lokale” zëvendësohet me “Vendore” dhe emërtimi “Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal” zëvendësohet me “Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano